



Prishtinë: 23.12.2014

Kodi i ZRRE-së: V_678_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1249_11_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **16.12.2014**.

në seancën e mbajtur më datë 23 dhjetor 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit P. A. (parashtruesi i ankesës B. A.) me shifër DPR - 124708 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1258_11_14** i datës 25.11.2014.

Arsyetim

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 05.10.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shtator 2013 me shpenzim prej **403 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **20.07€**, me datë 04.11.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën tetor 2013 me shpenzim prej **403 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **26.97€**, me datë 04.12.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2013 me shpenzim prej **403 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **26.97€**, me datë 05.01.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2013 me shpenzim **403 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **26.97€**, si dhe me datë 04.02.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2014 me **3,954 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **358.59€**. Pas arritjes së faturës së lartcekur konsumatori me datë 24.12.2013, 09.01.2014 dhe 12.02.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë nga periudha shtator 2013 deri në periudhën janar 2014.

Me datë 21.02.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 47555516, ku gjendja e shpenzimit në njehsor është: TL=015999 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=007460 kWh (tarifa e ulët).

Me datë 28.02.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e



inspektimit nr. 1015737 të datës 21.01.2014 duke bërë korrigjimin e faturave për periudhën tetor 2013 deri në janar 2014 në vlerë **-15.73€**.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 11.03.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 25.11.2014 ka nxjerrë vendim duke e **refuzuar** ankesën e konsumatorit.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së sepse është i bazuar në bazë të deklaratës së pavërtetë të lexuesit të KEDS-it cili ka deklaruar se nuk ka pasur çasje në pikën matëse. Konsumatori në ankesë ka theksuar se jeton në këtë shtëpi me të njëjtën pikë matëse që nga viti 2004 dhe se nga ky vit e deri sot është e njëjta çasje në pikë matëse dhe se është e njëjta shtëpi me të njëjtën pikë matëse dhe se gjatë kësaj periudhe 10 vjeçare lexuesi nuk ka pasur çasje vetëm në muajt e diskutuar në vendim, e që kjo është e pavërtetë. Andaj lidhur me këtë në të njëjtën lajthitje me lexuesin e KEDS-it ka ra edhe departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve dhe se i ka besuar lexuesit. Në fund konsumatori ka theksuar se kërkon nga Bordi të analizojë edhe njëherë ankesën e parashtruar nga konsumatorja dhe ta kthejë mbrapsht vendimin e lartpërmendur.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pas arritjes së faturave të energjisë elektrike nga periudha 09/2013 e deri më 01/2014 dhe ankesës së konsumatorit ndaj këtyre faturave, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 21.02.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrik në njëhisorin elektrik dhe se gjendje e shpenzimit të energjisë elektrike e evidentuar në procesverbal përputhet me shpenzimin e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe pikën e kundërshtimit ku theksohet se vendimi i DMK-së është bazuar në deklaratën e pavërtetë të lexuesit të KEDS-it për mos çasje në pikën matëse. Bordi i ZRRE-së sipas analizave të bëra listave të leximit të KEDS-it prej periudhës shtator 2013 deri në mars 2014 në të cilën ka munguar lista e leximit për periudhën janar 2014 konstaton se lexuesi i KEDS-it për periudhat 10/2013, 11/2013, 12/2013 ka evidentuar që nuk ka çasje në leximin e pikës matëse por që konsumatori ka harxhim, ndërsa për periudhat 02/2014 dhe 03/2014 ka bërë lexim të saktë shpenzimeve mujore. Sipas analizave të bëra listave të leximit Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se shpenzimet e energjisë elektrike të periudhave 10/2013 deri më 12/2013 është faturuar me shpenzimet e regjistruara në listën e leximit shtator 2013, për shkak se sipas lexuesit të KEDS-it nuk ka pasur çasje në pikën matëse por që ka pasur harxhim. Duhet theksuar se listat e leximit janë dokumente zyrtare.

Lidhur me këtë pasi që KEDS-i nuk ka arritur të sigurojë listën e leximit të periudhës 01/2014 ku vërehet se shpenzimi i energjisë elektrike për atë periudhë paraqet grumbullim të shpenzimit nga periudha 10/2010 e deri më 01/2014, Bordi i ZRRE-së ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorëve – kWh) nga periudha shtator 2013 kur edhe është bërë leximi deri në leximin e saktë në periudhën janar 2014 dhe gjatë shpërndarjes së shpenzimit ka rezultuar se korrigjimi i bërë nga Departamenti i faturimit në KEDS me datë 27.02.2014 në vlerë **-15.73€** është korrigjim i saktë dhe se nuk elemente tjera të korrigjimit financiar. Sipas kësaj Bordi i thekson se vendimi i DMK-së nuk është se bazuar vetëm në deklaratën e lexuesit të KEDS-it, por që duke analizuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në procesverbalin e kontrollës nr. 1015737 të datës 21.02.2014



përputhet me gjendjen në rrjedhën e energjisë e që i bie se kilovatorët e evidentuar në muajin 01/2014 janë të saktë si dhe pasi që KEDS-i nuk ka arritur të siguroj listën e leximit të periudhës 01/2014 ka bërë shpërndarjen e shpenzimit për periudhën, por që pas shpërndarjes ka rezultuar se nuk ka elemente të korigjimit shtesë.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë shtesë me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.12.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1249_11_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar